

Maqedonia e Veriut 2018-2019



Martesat e fëmijëve

Multiple Indicator
Cluster Surveys


Martesat e fëmijëve: nivelet dhe shpërndarja



Republic of North Macedonia
State Statistical Office




Martesa e moshës nën 15 dhe 18 vjeç: COR 5.3.1



Përqindja e grave të moshës 20-24 vjeçare të cilat janë martuar për herë të parë ose kanë hyr në bashkëjetesë nën moshën nën 15 dhe 18 vjeç. Grafiku i mësipërm u referohet grave të moshës prej 20 deri 24 vjeç, pasi ky grup më i ri ishte para do kohe ishte ekspozuar rrezikut nga martesa e fëmijëve, duke dhënë një vështrim më të afërt mbi përhapjen aktuale të martesave të fëmijëve. Grafikonet e mëposhtme, të cilët tregojnë shpërndarjen sipas veçorive statistikore, i referohen grupit të grave të moshës 20 deri në 49 vjeç.

Martesa në moshën nën 18 vjeç: shpërndarja



Përqindja e grave të moshës 20-49 vjeç të cilat janë martuar për herë të parë ose kanë hyrë në bashkëjetesë nën moshën 18 vjeç, sipas zonës, kuintilit të pasurisë dhe arsimit

Mesazhet kryesore

- Tetë përqind e grave të moshës 20-24 vjeç në vend janë kurorëzuar ose martuar për herë të parë para moshës 18 vjeç, ndërsa më pak se 1 përqind e grave të së njëjtës grupmoshë janë martuar ose kanë hyrë në bashkëjetesë nën moshën 15 vjeç.
- Nga gratë e moshës 20-49 vjeç, 10 përqind janë të martuara ose në bashkëjetesë para moshës 18 vjeç.
- Rezultatet sipas veçorive statistikore tregojnë

se përqindja e grave në një lidhje martesore apo bashkëjetesë para moshës 18 vjeç dallon nga gratë me nivele të ndryshme arsimore. Më pak se 1 përqind e grave me arsim të lartë u martuan nën moshën 18 vjeç krahasuar me 29 përqind të grave me ose pa arsim fillor.

- Në mënyrë të ngjajshme, 25 përqind e grave në kuintilin më të varfër janë martuar para moshës 18 vjeç, krahasuar me vetëm 2 përqind të grave në kuintilin më të pasur.

Rezultatet për gratë e martuara nën moshën 15 dhe 18 vjeç të grupmoshave të ndryshme mundësojnë që me kalimin e kohës të shënohen trende në martesat e fëmijëve. Trendet tregojnë një rënie të vazhdueshme të numrit të martesave para moshës 18 vjeç, ndërkohë që kohët e fundit përparimi është në ngecje.

Martestat e fëmijëve sipas përkatësisë etnike të kryefamiljarit


Përkatësia etnike e kryefamiljarit	Martesa në moshën nën 18 vjeç
Niveli nacional	10
Maqedonas	7
Shqiptar	7
Të tjera 1	30

Përqindja e grave të moshës 20-49 vjeç të cilat janë martuar për here të pare apo kanë hyrë në bashkëjetesë nën moshën 18 vjeç, sipas përkatësisë etnike të kryefamiljarit.

1 "Tjetër" përfshinë cilëndo nga pesë bashkësitë e tjera etnike që jetojnë në vend: Romë (2.7 përqind), Turq (3.8 përqind), Serbë (1.8 përqind), Boshnjakë (0.8 përqind), Vlleh (0.5 përqind), sipas Regjistrimit të fundit të popullsisë, 2002.

Martesa nën moshën 18 vjeç është një realitet për shumë vajza të reja. Në shumë vende të botës, prindërit inkurajojnë vajzat e tyre të martohen kur janë ende fëmijë, duke shpresuar se martesa do t'u sjellë përfitime financiare dhe sociale, dhe njëkohësisht duke lehtësuar barrën financiare të familjes. Në fakt, martesa e fëmijëve është një shkelje e të drejtave të njeriut, dëmton zhvillimin e vajzave dhe shpesh rezultojnë në shtatzëni të hershme dhe izolim social, arsim të pamjaftueshëm dhe trajnim të dobët profesional, duke përforcuar natyrën gjinore të varfërisë. E drejta për një pëlqim "të lirë dhe të plotë" për martesën njihet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut - duke pranuar se pëlqimi nuk mund të jetë "i lirë dhe i plotë" kur njëra nga palët e interesuara nuk është mjaftueshëm e pjekur për të marrë një vendim të informuar në lidhje me partnerin e jetës.

Trendet e martesave të fëmijëve



Përqindja e grave të moshës 20-49 vjeç të cilat janë martuar për herë të parë apo kanë hyrë në bashkëjetesë nën moshën 15 dhe 18 vjeç, sipas grupmoshës

Hulumtimi në klaster me më shumë indikator në Maqedoninë e Veriut (MIKS) është realizuar gjatë viteve 2018-2019 nga ana e Entit Shtetëror të Statistikës, si pjesë e programit global MIKS. Mbështetje profesionale siguroi Fondi për fëmijë pranë Kombeve të Bashkuara (UNICEF), me mbështetje financiare të UNICEF-it, Fondit për popullsi të Kombeve të Bashkuara dhe ambasadës së Britanisë.

Qëllimi i kësaj pasqyre është që të publikohen gjetjet e përzgjedhura të MIKS-it për Maqedoninë e Veriut për vitin 2018-2019 në lidhje me martesat e fëmijëve. Të dhënat nga kjo pasqyrë mund të gjenden në tabelën PR.4.1.W.

Pasqyrat shitesë statistikore dhe Raporti me gjetjet e këtij dhe hulumtimeve tjera janë në dispozicion në mics.unicef.org/surveys.